



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K. të datës 24.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 20.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K. e datës 24.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 20.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.
- II. **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 20.02.2023 i autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik TSR Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "TSR" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 24.02.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 20.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.

Pretendimet e parashtruesit janë lidhur me çmimet jo normalisht të ulta të ofertës së tenderuesit të rekomanduar nga komisioni vlerësues. Njëkohësisht parashtruesi në kërkesën e tij ka potencuar se *“Firma Visover nga Spanja, ne me të drejtë dyshojmë se kjo firmë nuk merret me produktet e sinjalizimit vertikal”*. Po ashtu parashtruesi ka pretenduar se tenderuesi i rekomanduar si i sukseshëm nuk ka dëshmuar pajisjen *“Semafor mobil për sigurimin e vend punishtes gjatë realizimit të sinjalizimit – 2 copë”* në përputhje me aneksin 7 të DT. Për këto arsye, parashtruesit pretendon se është vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 52, 56, 59, 61 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si “LPP”) si dhe nenin 41 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të RRPP, autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 02.03.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim janë të bazuara në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP, për arsyet e elaboruara si në vijim.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar dëshmitë për *“Semafor mobil për sigurimin e vend punishtes gjatë realizimit të sinjalizimit – 2 copë”* - aneksi 7 në DT, është gjetur se sipas Formularit B54 Standard për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara të datës 05.12.2022, nuk është kërkuar një dëshmi e tillë. Rrjedhimisht ky kriter nuk ka qenë pjesë e vlerësimit nga komisioni vlerësues. Për këto arsye është konstatuar se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Sa i përket dyshimeve të parashtruesit se prodhuesi për të cilën tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar një autorizim të prodhuesit (Viseover nga Spanja) nuk merret me produktet e sinjalizimit vertikal, është gjetur se parashtruesi nuk ka arritur të konfirmoj dyshimin e tij me ndonjë argument apo dëshmi. Njëkohësisht as autoriteti kontraktues nuk ka arritur të konfirmoj këtë dyshim të parashtruesit. Për këtë arsye është konstatuar se ky dyshim i parashtruesit është i pabazuar.

Ndërsa sa i përket pretendimit të parashtruesit lidhur me çmimin jo-normalisht të ulët, fillimisht duhet theksuar se përmes nenit 41 paragrafit 41.1. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcaktohet se *“Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës”*.

Tutje përmes nenit 41 paragrafit 41.3. të RRPP përcaktohet se *“Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”*.

Bazuar në Raportin e Komisionit për Vlerësim në këtë aktivitet të prokurimit ekzistojnë nëntë (9) operator ekonomik të përgjegjshëm të cilët kanë dorëzuar ofertat e tyre. Në përputhje me nenin 27 paragrafin 1 të LPP, Komisioni për Vlerësim bazuar në kriterin e tenderimit *“Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë”* ka rekomanduar si tenderues të sukseshëm operatorin ekonomik *“Sinjal” Sh.P.K.* me çmim total të ofertës 44.44 Euro.

Ndërsa si tenderuesin e dytë me çmimin më të ulët komisioni vlerësues e ka renditur Grupin e Operatorëve Ekonomik "Lindi Markings" Sh.P.K. & "Beni-Com" Sh.P.K. me çmim total prej 51.50 Euro. Kjo nënkupton që çmimi i ofruar nga tenderuesi i rekomanduar është 13.70% (pra mbi 10%) më i ulët se çmimi i ofruar nga tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin e dytë më të ultë pas tenderuesit të rekomanduar. Tutje, sipas raportit të komisionit vlerësues çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm është 108.36 Euro. Kjo nënkupton se çmimi i ofruar nga tenderuesi i rekomanduar është 58.98% (pra mbi 30%) më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm. Sipas të dhënave si sipër të raportit të komisionit për vlerësimin e tenderëve, mund të konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara me nenin 41 paragrafin 41.3. të RRPP për shkak të cilave autoriteti kontraktues duhet të kërkoj nga operatorët ekonomik që të shpjegojnë çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm.

Sipas nenit 61 paragrafit 1 të LPP "Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni". Megjithatë, nga Raporti i Vlerësimit të Tenderëve nuk është gjetur se Komisioni i Vlerësimit ka ndërmarrë veprimet e përcaktuara me nenin 61 paragrafin 1 të LPP lidhur me nenin 41 paragrafin 41.1. të RRPP, përkundër faktit se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me nenin 41 paragrafin 41.3. të RRPP.


Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parashtruesit lidhur me çmimin jo normalisht të ulët është i bazuar për faktin se Komisioni Vlerësues nuk ka ndërmarrë veprimet e përcaktuara me nenin 41 paragrafin 41.3 të RRPP lidhur me nenin 61 paragrafin 1 të LPP. Sa i përket konstatimit të parashtruesit se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë përcaktimin e sasive të planifikuara, parashtruesi nuk ka arritur të shpjegoj apo argumentoj se për çfarë shkelje bëhet fjalë në këtë rast. Përndryshe autoriteti kontraktues konsideron se parashtruesi ka mundur të parashtroj këtë pretendim përmes kërkesës për rishqyrtim kundër njoftimit mbi kontratën.

Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. të RRPP. Për pikën II dhe III të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në 7 të LPP lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.3. pikën a) të RRPP. Për pikën IV dhe pikën V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 02.03.2023

Visar SHEHU  
Ud. Udhëheqës Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.